REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS DEÇAN

Numri i lëndës: 2023:168294

Datë: 26.02.2024

Numri i dokumentit: 05376853

P.nr.177/23

GJYKATA THEMELORE NË PEJË/ DEGA NË DEÇAN -DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, gjyqtari i çështjes Armend Lokaj, me zyrtaren ligjore Sabiha Hoxha, në çështjen penale kundër të pandehurit F.H., për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 1, nën par. 1.4 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë PP/II.nr.1290/2023, të datës 04.08.2023, në bazë të nenit 357, par. 1, nën par. 1.3, të KPPK-së dhe nenit 12, par.1.2.5, të Ligjit mbi Ndërmjetësimin, jashtë seancës, me datë **26.02.2024**, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. **APROVOHET** marrëveshja për ndërmjetësim, e lidhur në mes të pandehurit F.H.**dhe të dëmtuarës A... H....**, në Qendrën e Ndërmjetësimit në Deçan Nd.nr.111/2024, e datës 26.02.2024.

II. **HEDHET** Aktakuza e Prokurorisë Themelore në Pejë PP/II.nr.1290/2023, e datës 04.08.2023 dhe,

III. **PUSHOHET** procedura penale për të pandehurin:

IV. F.H., nga M...., e ëma R..., e gjinisë E...., i lindur më datë ...., në fshatin S i E...., Rr.”S.... H....”, Komuna e D....., ku dhe tani jeton, me numër personal ....., me numër të tel. ....., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

-për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 1, nën par. 1.4 të KPRK-së.

V. Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A R S Y E T I M

2023:168295

Prokuroria Themelore në Pejë, me aktakuzën PP/II.nr.1290/2023, të datës 04.08.2023, e ka akuzuar të pandehurit F.H., për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 1, nën par. 1.4 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 26.02.2024, në të cilën kanë prezantuar prokurori i shtetit Arlinda Nallbani – Gacaferri, e dëmtuara A.... H....., i pandehuri F.H.dhe mbrojtësi i të pandehurit sipas autorizimit, av. Nexhat Musaj.

Në seancën e shqyrtimit fillestar i pandehuri dhe mbrojtësi i tij kanë propozuar që çështja penale të referohet në procedurën e ndërmjetësimit për faktin se janë pajtuar me të dëmtuarën.

E dëmtuara A....H.... është pajtuar që çështja penale të refereohet në procedurëne ndërmjetësimit duke deklaruar se unë dua t'ia fali dhe nuk dua të kem asnjë kontakt me të pandehurin.

Prokurori i shtetit ka deklaruar se pajtohem që kjo lëndë të referohet në procedurën e ndërmjetësimit meqenëse ligji e lejon dhe po ashtu e dëmtuara është pajtuar që kjo lëndë të referohet në procedurën e ndërmjetësimit.

Gjykata përmes aktvendimit procedural, ka aprovuar propozimin e palëve që kjo lëndë të referohet në procedurën e ndërmjetimit duke e pezulluar çështjen penale në afat prej 90 ditëve.

Gjykata përmes vendimit me numër të lëndës 2023:168294, të datës 26/02/2024, ka referuar rastin në ndërmjetësim duke e obliguar referentin e gjykatës për ndërmjetësim që në bazë të kompetencave ligjore të zhvilloj procedurën për administrimin e rastit në procedurën e ndërmjetësimit.

Me datë 26.02.2024, në Qendrën e Ndërmjetësimit në Deçan, është lidhur marrëveshja për zgjidhjen e çështjes në procedurën e ndërmjetësimit ndërmjet palëve: F H, dhe të dëmtuarës A H, të cilën marrëveshje e ka aprovuar edhe gjykata me aktvendim, dhe ndaj të pandehurit F H ka pushuar procedurën penale.

Palët pa ndonjë kërcënim dhe me vetë dëshirë kanë shprehur gatishmërinë që kjo çështje të zgjidhet dhe nuk kontestojnë asnjë nga pikat e lartpërmendura të marrëveshjes.

Qendra për Ndërmjetësim, me datë 26.02.2024, me vendimin Nd.nr.111/2024, ka arrit marrëveshjen e palëve për zgjidhje të ndërmjetësuar.

Gjykata duke u bazuar në provat si më lart, dhe në bazë të nenit 357, par. 1, nën par. 1.3, të KPPK-së dhe nenit 12, par.1.2.5, të Ligjit mbi ndërmjetësimin, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

2023:168295

GJYKATATHEMELORE NË PEJË/DEGA NË DEÇAN-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.177/23 datë 26.02.2024.

Sekretare juridike,
Sabiha Hoxha
_____

Gjyqtari
Armend Lokaj
_____

Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesa
Kjo marrëveshje e ka fuqinë e titullit ekzekutiv.